



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	23 - 08	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5788/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.970/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Arben Mehmeti-kryetar; Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtës, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.970/2023 të datës 14.07.2023 të parashtruar nga ankuesja _____, nga Peja, kundër organit të punësimit/Komunës së Pjesë, në çështjen juridike "*shkelje e të drejtës në pagë*", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr. 970/2023 e datës 14.07.2023 e parashtruar nga ankuesja .

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, Luljeta Cena, e punësuar në Komunën e Pejës, sipas Akt Emërimit të datës 04.01.2012 në pozitën "*Zyrtare e Z.K.GJ.C*", më datë 08.06.2023 ka parashtruar kërkesë tek Menaxheri i Zyrës së Personelit të Komunës së Pejës lidhur me kategorizimin e pozitës në Profesionale 3. Menaxheri i Burimeve Njerëzore i Komunës së Pejës më datë 13.06.2023 përmes përgjigjes në ankesë njofton ankuesen se nuk është kompetencë e komunës rregullimi i koeficienteve por kjo është kompetencë e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ankuesja kundër kësaj përgjigjeje përmes postës më datë 11.07.2023 ka parashtruar ankesë për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 14.07.2023 dhe është regjistruar nënë shenjën A.nr.970/2023, me pretendimin ankimor së kategorizimi i pozitës së ankueses në klasën "Profesional 3" është bërë në shkelje të dispozitave materiale dhe në vlerësimin e ankueses pozita e saj duhet të klasifikohet në "Profesional 2".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 18.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Pjesë. Kjo e fundit, më datë 26.07.2023, i përcolli shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës, rezulton së ankuesja sipas Akt Emërimit të datës 04.01.2012 ka realizuar koeficientin e pagës pesë (5), ndërsa në muajin shkurt 2023, me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesja është klasifikuar në klasën "Profesional 3".

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit i analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr. 10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit, nga analizimi i shkresave të lëndës, ka gjetur se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Pjesë ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankueses në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së saj të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve, të përcaktuar me Vendimin Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë së me nenin 29 të Rregullores (QRK), Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë të obliguara që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, gjegjëshit deri me datë 30.09.2023. Kolegji i Këshillit vlerëson së ankesa e ankueses, për kategorizimin e pozitës së saj në kategorinë "Profesional 2" është e parakohshme, si e tillë, në këtë fazë, nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritor, rrjedhimisht, e njëjta, është e papranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit, theksuar si me sipër, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitave të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar më lart, ankuesit do t'i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankesës për klasifikimin e pozitës së saj të punës.

Kështu që, mbështetur në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, i Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi të Këshillit, pala e pakënaqur, e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.970/2023, datë 23/08/2023.

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

